



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1524 / Prot.
2

Patos më, 20/06/2024

VENDIM

Nr. 47, datë 14.06.2024

**MBI PROJEKT DOKUMENTIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM FAZA
E PARË 2025-2027.**

Në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 03, datë 28.02.2024 i Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e buxhetit afatmesëm vendor” VKB nr. 13, datë 29.02.2024 “Për vlerësimin, parashkrimin afatmesëm të të ardhurave të bashkisë Patos për vitet 2025-2027”, VKB nr. 24, datë 29.03.2024 “Për miratimin e tavanëve përgatitor të PBA 2025-2027”, udhëzimit të brendshëm nr. 01 datë 12.04.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur më datë 14.06.2024 pasi analizoi projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Menaxhimit

VENDOSI:

1. Të miratoj projekt dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 faza e parë.
2. Bashkëlidhur vendimit projekt dokumenti i PBA-së vendor 2025-2027 faza e parë dhe tabelat të përgatitura sipas sistemit të menaxhimit buxhetor (smbv.fvv.al) dhe shtojcave të udhëzimit nr. 3, datë 28.02.2024 .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë.
4. Ky vendim u shpall në datën 20.06.2024.
5. Vendimi hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.



KRYETARI
Armand Ahmetaj